



REPubLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 806/1 Prot

Elbasan më 03 /02/2026

VENDIM

Nr 16 datë 02 /02/2026.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2026
Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 02 /02/2026

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin JANAR 2026, 81 familje me fond 247.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Pranoi : Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr finance
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Konfirmoi: Zv/Kryetar
Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

M.Duka
A.Hoxha
A.Merkja
D.Shuli
A.Shehu

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar me 34 vota

Pro 33

Kundër 0

Abstenim 1

806/2
06.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 313/1 Prot

Elbasan, më 6 . 3 .2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.16, datë 02.03.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Janar 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 807/11 Prot

Elbasan më 03/02/2026

VENDIM

Nr. 17 datë 02/02/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Sherbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **JANAR 2026** për **256** familje me një fond prej **1.199.691** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Pranoi : Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
A.Hoxha
A.Merkja
D.Shuli
A.Shehu

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Miratuar me ____vota

Pro 32

Kundër 0

Abstenim 0

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

007/2
06.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 312/1 Prot

Elbasan, më 6. 3.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.17, datë 02.03.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESHIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE
SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 813/1 prot

Elbasan me 03/02/2026

V E N D I M

Nr 18 /datë 02/03/2024

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 02/03/2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/2006 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

V E N D O S I

I. Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

I moshuari Z. Peter Subashi, i datëlindjes 20.06.1954, vendbanimi Elbasan, lagje Beqir Dardha, me nr. ID F40620003N.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Drejtoria e Qendrës Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm D. Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha

P/ Drejtori Buxhet-Finance
A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESI SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE
SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1053/1 prot

Elbasan me 03/03/2026

V E N D I M

Nr. 19 /datë 02/03/2026

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 02/03/2026 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/2006 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

V E N D O S I

I. Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

E moshura Znj. Xhuljeta Balukja, i datëlindjes 09.08.1964, vendbanimi Elbasan, lagje Visarjon Xhuvani, me nr. ID G45809041K.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Drejtoria e Qendrës Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm

D. Roseni

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Finance


A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1034/1 Prot.

Datë 03 .02. 2026

VENDIM

NR. 20 DATË 02 .02. 2026

MBI

“Detajim i grantit të bazuar në performancë, me burim financim i huaj”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .02.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Detajim i grantit të bazuar në performancë, me burim financim i huaj”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, shkresën e Ministrisë së Financave, nr.18133/1, datë 24.12.2025, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20, dhe nr.1, datë 11.07.2025, datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”,

VENDOSI

1. Fondi 7,777,652.32 lekë, Grant i Bazuar në Performancë, me burim financim i huaj, trashëguar nga viti 2025, të përdoret për investime në buxhetin e vitit 2026, si më poshtë :

Objekti: “Sistemi i ri i menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore”, shuma 7,777,652.32 lekë programi AA109, funksioni 01120, artikulli 231, njësia shpenzuese Bashkia.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë dhe Drejtoria e prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elsid Zyma


P/Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr.Buxhet Finance : A.Merkja

D.P.SH.M: S. Mehmeti

Dr.Juridike: A. Hoxha

KRYETARI
Lutfi Lala



1034/2
06.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 314/1 Prot

Elbasan, më 06.03.2026

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” , pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.20, datë 02.03.2026 “Detajim i grantit të bazuar në performancë, me burim financim i huaj”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

P R E F E K T I

BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1043/1 Prot.

Datë 03 .03. 2026

VENDIM

NR. 21 DATE 02 . 03. 2026

MBI

“SHITESË E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE E SHPENZIMEVE, NGA FONDET ME BURIM FINANCIM I HUAJ, NË BUXHETIN E VITIT 2026”

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 10, datë 12.7.2024, i Ministrisë së Financave “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare”,

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, me burim financimi i huaj, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si më poshtë:

A. Të ardhura gjithsej : **26,507,114.92 lekë**

- Projekti: “Administratat publike përballen me transformimin digital si komunitet, në zonën e Adrion”, **102,121.92 lekë**;
- Projekti: “Energjia e gjelbër dhe e qëndrueshme në ndërtesat e Elbasanit 2024-2026”, **13,092,307 lekë**;
- Projekti: “Inovacioni klimatik-neutral i Elbasanit në levizshmëri (eCIM)” **13,312,686 lekë**.

B. Shpenzime gjithsej : **26,507,114.92 lekë**

Detajimi i shpenzimeve, njësia shpenzuese Bashkia :

	<i>në lekë</i>
1. Produkti P111AAV, artikulli 600, kap. 02, paga stafi	<u>52,459</u>
2. Produkti P111AAV, artikulli 602, kap. 02, shpenzime operative	<u>49,662.92</u>
3. Produkti P563AAG, artikulli 602, kap. 02, shpenzime operative	<u>13,092,307</u>
4. Produkti P563AAH, artikulli 602, kap. 02, shpenzime operative	<u>13,312,686</u>
Gjithsej	<u>26,507,114.92</u>

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elsid Zyma


KRYETAR
Lutfi Lala

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxhet Financë : A.Merkja

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : K. Krasnika



1043/2

06.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 315/1 Prot


Elbasan, më 6.3.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.21, datë 02.03.2026 "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, nga fondet me burim financim i huaj, në buxhetin e vitit 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 945/1 Prot.

Datë 03 . 02. 2026

VENDIM

NR. 22 DATË 02 . 02. 2026

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2025”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 02 .02.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2025”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,


VENDOSI

1. Të miratojë “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2025 (janar-dhjetor)”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala

P.Sekt.Buxhetit: M.Behluli
Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M: S. Mehmeti
D.P.K.S.A.R.S : D.Roseni
D.P.M.C.M.B.P.K : Sh. Çullhaj
Dr.Juridike: A.Hoxha
Zv/kryetar : K. Krasnika



345/2

11.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 316/1 Prot

Elbasan, më 11.3.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.22, datë 02.03.2026 “ Raportit i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (Janar-Dhjetor 2025)”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ili Bejtja




BASHKIA ELBASAN

**RAPORT MONITORIMI
BUXHETI 2025**

NR. 945.7107

DT. 23.02.2026

PROGRESIV 4- MUJORI I TRETË 2025



SHKURT 2026

Përmbajtja:

Buxheti i Bashkisë për vitin 2025, 4 Mujori i III-të (periudha janar- dhjetor)

Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2025, 4 Mujori i III-të (periudha janar- dhjetor)

Realizimi i buxhetit për vitin 2025, 4 Mujori i III-të (periudha janar- dhjetor)

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Elbasan ushtron funksione të vetat dhe të deleguara, duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale.

F1. Funksioni “Shërbime të përgjithshme publike”

F2. Funksioni “Shërbime të huamarrjes vendore”

F3. Funksioni “Rendi dhe siguria publike”

F4. Funksioni “Çështje ekonomike”

F5. Funksioni “Mbrojtja e mjedisit”

F6. Funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”

F7. Funksioni “Argëtimi, kultura dhe feja”

F8. Funksioni “Arsimi”

F9. Funksioni “Mbrojtja Sociale”

1.BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2025 (4 mujori i III-të)

Detajimi i buxhetit për vitin 2025 është hartuar bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07. 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017, datë 27.4.2017 “Pë financat e vetëqeverisjes vendore“, si dhe VKB nr. 138, datë 26.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, i ndryshuar.

Programi Buxhetor i vitit 2025 parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2025 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social-ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 9 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 9 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi “Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse”
2. Programi “Rendi dhe siguria publike”
3. Programi “Çeshtjet ekonomike dhe bujqësia”
4. Programi “Mbrojtja e mjedisit”
5. Programi “Zhvillimi urban dhe shërbimet publike”
6. Programi “Argëtimi, kultura dhe sportet”
7. Programi “Arsimi”
8. Programi “Mbrojtja civile”
9. Programi “Fondi rezervë dhe kontigjenca”

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2025, vijnë nga dy drejtime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione, dhe të ardhura të trashëguara.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë.

- 8 Fondet e kushtëzuara të cilat vijnë nga buxheti i shtetit për financimin e funksioneve të deleguara si gjendja civile, ndihmat ekonomike, bursat etj. nuk janë objekt i monitorimit të buxhetit të Bashkisë, por në këtë material do të merrni informacion të përgjithshëm mbi përdorimin e fondeve.

I. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2025

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe të ardhurat nga funksionet specifike, si shërbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, Bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuara në lehtësimin maksimal fiskal, ndikuan në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet strukturave të bashkisë dhe agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime, të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, ndikuan në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për rritjen e të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Këto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve..

➤ KATEGORIZIMI I TË ARDHUARAVE

Taksat vendore:

- ☐ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- ☐ Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- ☐ Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- ☐ Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- ☐ Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri në 8 milion,

Taksat e ndara:

- ☐ Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
- ☐ Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
- ☐ Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- ☐ Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale

Tarifat vendore:

- ☐ Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- ☐ Tarifa për ndriçimin publik
- ☐ Tarifa për gjelbrimin
- ☐ Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan
- ☐ Tarifa për parkimin e mjeteve e licensuara dhe vendparkime publike
- ☐ Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
- ☐ Tarifa për zënien e hapësirave publike
- ☐ Tarifa nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

Të ardhura të tjera:

- ☐ Të ardhura nga gjoba
- ☐ Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.


Të ardhura nga huaja:

Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për periudhën janar- dhjetor 2025

në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi 2025
1	Të ardhurat nga taksat	556,250	353,074	63%
2	Të ardhura nga taksat e ndara	161,400	178,337	110%
3	Te ardhurat nga tarifat vendore	604,940	429,021	71%
4	Te ardhura te tjera	327,462	102,999	31%
5	Te ardhura nga donacionet (jashtë limiti)		27,670	
	TOTALI	1,650,052	1,091,102	66%

Paraqitja grafike:




Realizimi faktik i te ardhurave sipas muajve janar-dhjetor paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

MUAJI	JANA R	SHKU RT	MAR S	PRIL L	MAJ	QERSH OR	KORRI K	GUSH T	SHTAT OR	TETO R	NENT OR	DHJET OR
TE ARDHU RA	60,39 2	57,449	36,85 0	54,46 5	73,88 1	85,959	265,436	108,13 6	78,817	112,42 8	72,023	85,266

Paraqitja grafike:



Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Muaji janar pati një rritje të nivelit të të ardhurave krahasuar me muajin shkurt dhe mars, në muajin prill reflektohet tendencë në rritje e cila vazhdon deri në muajin korrik, muaj i cili përkon me afatin e fundit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Elbasan. Në muajin gusht konstatohet një ulje e nivelit të arkëtimeve krahasuar me korrikun, por kemi një rritje të konsiderueshme krahasuar me të gjithë muajt e periudhës janar- qershor, përgjatë muajve tetor, nëntor dhjetor kemi një tendencë në rritje krahasuar me muajt e parë të vitit.

➤ Realizimi i të ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor 2025.

Nr		PLAN 2025	FAKTI 2025	REALIZIM 2025
I	TE ARDHURA			
B	TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI+VII)	1,650,052	1,063,432	64%
I	TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	556,250	353,074	63%
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	2,000	534	27%
2	Taksa mbi ndertesat	258,300	193,402	75%
3	Taksa mbi token bujqesore	27,100	20,141	74%
4	Taksa mbi truallin	31,750	28,046	88%
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	10,000	8,156	82%
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	220,000	95,723	44%
7	Taksa e tabelës	7,100	7,072	100%
II	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	161,400	178,337	110%
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	13,000	6,487	50%
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	87,600	92,987	106%
3	Taksa e rentes minerare	800	547	68%
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	60,000	78,317	131%
III	TE ARDHURA NGA TARIFAT	604,940.00	429,021	71%
1	Tarife per zenien e hapesires publike	32,300	26,430	82%
2	" pastrimi	260,950	185,980	71%
3	" gjelberimi	69,750	43,653	63%
4	" ndricimi	96,300	68,377	71%
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin.	5,700	4,548	80%
6	" reklame	4,500	4,374	97%
7	" parkim automjete	30,000	14,984	50%
8	" embleme bashkie	70	74	106%
9	" leje, certificate transporti	2,200	2,291	104%
10	" autorizim treg. karburanti + lende djegese	10,000	6,239	62%
11	" leshimin e vertetimeve	2,150	1,456	68%
12	" autoriz., zgjatje orari ,etj	2,600	2,019	78%
13	" sherbimi karrotresh	500	27	5%
14	" leje perdorimi per objekte biznesi	1,000	2,156	216%
15	" leje perdorimi per banim	600	737	123%
16	" certifikim relievi	2,300	840	37%
17	" deklarim paraprak	1,500	1,183	79%
18	" trajt.fasades ndertesave	2,000	1,291	65%
19	" aplikim leje zhvillimi	500	75	15%
20	" hartim PDV per siperfaqen e prones	8,000	1,734	22%
21	" shqyrtim dokumenta leje ndertimi	1,200	1,969	164%
22	" kantier ndertimi brenda prones	5,000	6,295	126%
23	" depozitimi i mbetjeve te ngurta	25,000	17,954	72%

24	"	leshimin e dok.nga arkiva	100	44	44%
25	"	rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	2,197	100%
26	"	rrjetin e tubacion.ujrave zeza	300	283	94%
27	"	sherbimi per rrjetin kabllor	3,200	3,300	103%
28	"	uji pijshem	20	1	6%
29	"	per mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit	35,000	28,510	81%
IV		TE ARDHURA JO-TATIMORE	177,430	20,104	11%
1		Qera objekti	500	456	91%
2		Qera trualli (toke e pafrytshme)	120	-	0%
		Qera toke bujqesore	310	215	69%
3		Gjoba ndertimi	70,000	200	0%
4		Gjoba biznesi	10,500	11,598	110%
5		Gjoba policia bashkiake	1,000	3,077	308%
6		Te ardhura nga legalizimet	50,000	1,575	3%
7		Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)	45,000	-	0%
8		Qera Trualli		-	
9		Te ardhura nga shitja ndertime		-	
10		Sekuestri dhe zhdemtime		-	
11		Kontributi subj.private ne fondin publik te ban.sociale		2,983	
V		TE ARDHURA INSTITUCIONET	76,832	55,053	72%
1		Qendra Ekonomike Arsimit	53,286	34,107	64%
		Te ardhura nga Cerdhet	11,616	7,138	61%
		Te ardhura nga kopeshtet	33,493	18,675	56%
		Te ardhura nga konviktet		42	
		Te ardhura nga qerate	8,177	8,252	101%
2		Te ardhura Klubi Shumesporte (DPKS)	1,246	1,482	119%
		Te ardhura nga qira objekti	1,246	1,257	101%
		Te ardhura okupim salle		225	
3		Teatri "Skampa"(DPKS)	900	1,425	158%
		Te ardhura nga biletat	700	1,290	184%
		Te ardhura okupim salle	200	135	68%
4		Trashegimia Kulturore dhe Turizmi(DPKS)	300	438	146%
		Te ardhura Trashegimia Kulturore	300	438	146%
		Te ardhura Biblioteka	0	-	
5		Agjensia e Sherbimeve Publike Rurale	500	-	0%
1		Te ardhura nga qira mjetesh	500	-	0%
				-	
6		Agjensia e Sherbimeve Publike Urbane	13,100	10,120	77%
		Te ardhura sherbimet publike	100	25	25%
		Te ardhura M.Varreza	11,000	9,565	87%
		Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne punime per riparimin e varreve	2,000	530	27%
7		Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira	7,500	7,482	100%
		Te ardhura nga qirate	7,500	7,482	100%
VI		TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE	73,200	27,842	38%
1		Te ardhura nga Zjarrfikesja(AMK)	2,000	1,460	73%
2		Te ardhura Ujitja dhe Kullimi (bashkia)	6,000	7,937	132%
3		Te ardhura nga Sherbimi Pyjor(ashpr)	65,200	18,445	28%

Te ardhura nga vertetime, etj.	800	173	22%
Tarife per lende drusore	30,600	7,589	25%
Qera per pyje dhe kullota	33,800	10,662	32%
Shitje produkte pyjore		4	
Te tjera Gjoha (kamat vonesa)		18	
Te ardhura Jashte Limiti		27,670	
TOTAL	1,650,052	1,091,102	66%

Ne tabelën e mësipërme vërehet se të ardhurat totale për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në masën **66%**, ose në vlerë totale **1,091,102** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga taksat vendore (përfshirë debitorët në vite) për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në masën **63%**, ose në vlerë totale **353,074** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga taksat e ndara për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në masën **110%**, ose në vlerë totale **178,337** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga tarifat (përfshirë debitorët në vite) për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në masën **71%** ose në vlerë totale **429,021** mijë lekë.

Nga këto të ardhurat e tjera për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në masën **31%** ose në vlerë totale **102,999** mijë lekë.

Nga këto, të ardhurat nga donacionet për 4 mujorin e tretë të vitit 2025, janë realizuar në vlerë totale **27,670** mijë lekë.

Në planin e të ardhurave, miratuar në buxhetin e vitit 2025, janë planifikuar "Arkëtim debitorë", për shumën 151,500,000 mijë lekë, i ndarë 76,500 mijë lekë (162,500 -86,000) detyrime të prapambetura nga familjarët (UKE) dhe 75,000 mijë lekë nga subjektet.

Gjithashtu, këto detyrime janë shpërndarë në tabelën e mësipërme, plan dhe fakt, vjetor sipas zërave të taksave dhe tarifave.

Nr.	Të ardhurat nga burime të huaja	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi 2025 %
1	Financim i huaj (Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit)	4,964	1,598	34%
2	Financim i huaj (Energjia e gjelber dhe e qëndrueshme ne ndertesat e qytetit te Elbasanit 24-26)	15,241	2,149	14%
TOTALI:		20,205	3,747	19%


➤ Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qendrore për vitin 2025.

në mijë lekë

Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qendrore për vitin 2025 (realizimi janar-dhjetor)

1	Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	1,063,432
2	Të ardhura jashte Limiti (donacione + takse pulle Gj.civile)	27,670
3	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	1,147,754
4	Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)	668,618
5	Të ardhura të trashëguara nga viti 2024 (të ardh. veta + grante + j.limiti)	419,189
6	Financime te huaja (viti + te trashëguara)	30,254
7	Huamartja	0
8	Te Ardhura nga Transfertat e kushtezuara	2,348,782
TOTALI		5,705,699

Paraqitje grafike:



1.Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar **1,063,432** mijë lekë, ose **19%** e të ardhurave të përgjithshme.

2.Të ardhura nga donacione janë realizuar **27,670** mijë lekë.

3.Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar janë realizuar **1,147,754** mijë lekë, ose **20.1%** e të ardhurave të përgjithshme.

4.Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike) janë realizuar **668,618** mijë lekë, ose **11.7%** e të ardhurave të përgjithshme.

5.Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar janë realizuar **2,348,782** mijë lekë, ose **41.2%** e të ardhurave të përgjithshme.

6.Të ardhura të trashëguara nga viti 2024 janë realizuar **419,189** mijë lekë ose **7.3%** e të ardhurave të përgjithshme.

7.Financime të huaja janë realizuar **30,254** mijë lekë ose **0.5%** e të ardhurave të përgjithshme.

II. REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2025

Realizimi i buxhetit për vitin 2025 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe VKB nr. 138, datë 26.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, i ndryshuar.


Shpenzimet e buxhetit sipas programeve buxhetore, për periudhën janar-dhjetor 2025, me burim financimi (transferta e pa kushtezuar, transferta e pakushtezuar sektoriale, të ardhurat nga taksat dhe tarifat, të ardhura jashtë limiti dhe financim i huaj), arritën në **2,976,715** mijë lekë me një nivel realizimi prej **74%**.

PROGRAMI	EMERTIMI	PLANI 2025	FAKTI 2025	REALIZIMI 2025 %
AA109	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	628,744	544,332	87%
AB109	Rendi dhe Siguria Publike	235,344	107,284	46%
AC109	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	719,931	454,608	63%
AD109	Mbrojtja e Mjedisit	369,125	291,357	79%
AE109	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	447,013	377,707	84%
AF109	Argëtimi , Kultura dhe Sportet	225,806	180,492	80%
AG109	Arsimi	1,038,000	785,720	76%
AH109	Mbrojtja Civile	317,248	235,215	74%
AI109	Fondi Rezervë dhe Kontigjenca	17,000	-	0%
	TOTALI	3,998,211	2,976,715	74%

Të dhënat ekonomike:

EMERTIMI	PLAN 2025	FAKTI 2025	REALIZIMI 2025 %
Paga+Sigurime(600+601)	1,758,907	1,526,636	87%
Shpenzime operative (602+651+166)	1,094,780	841,516	77%
Transferta (604+605+606+609)	212,130	57,778	27%
Investime (230+231)	932,394	550,785	59%
Totali	3,998,211	2,976,715	74%

Paraqitja grafike:



Bazuar në shpenzimet faktike të katër mujorit të tretë vitit 2025 :

Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën **87%**, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatorët e kopështeve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave etj, sipas funksioneve të cilat iu deleguan bashkive pas reformës territoriale.

Një zë i rëndësishëm janë shpenzimet operative, të cilat janë realizuar në masën **77%** të planit, financuar këto nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat sektoriale, të ardhurat tona dhe të ardhurat jashtë limiti.

Shpenzimet për paga zënë **51%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar me burim financimi **46%** transfertën e pakushtëzuar dhe **19%** të ardhurat e veta, **35%** me transfertë specifike

Shpenzimet operative zënë **28%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **32%** me burim financimi transfertën e pakushtëzuar **8%** transfertën sektoriale, **59%** të ardhurat e veta dhe **1%** jashtë limiti.

Shpenzimet për transferime zënë **2%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **44%** me transfertë të pakushtëzuar, **10 %** transfertën sektoriale, **41%** të ardhurat e veta dhe **4%** jashtë limiti.

Shpenzimet për investime zënë **19%** të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar **27%** me burim financimi transfertën e pakushtëzuar **8%** transfertën sektoriale, **63%** të ardhurat e veta dhe **3%** jashtë limiti.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2025, (Grant+G.Specifik+te Ardihura+J.Limiti,2+4)											në mijë lekë	
Programi	kod/Prog rami	Shpenzime Personeli		Shpenzime Operative		Transferta+ Subvencione		Shpenzime Kapitale		Total Buxheti		
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	423,230	402,011	132,783	101,354	39,891	14,574	32,840	26,393	54,4332	
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	90,630	85,595	12,551	10,351	113,473	8,722	18,690	2,616	107,248	
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	179,993	145,222	96,451	60,888	9,904	9,904	433,583	238,594	454,608	
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	26,164	21,952	307,468	247,993	40	40	35,453	21,372	291,357	
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	163,020	143,620	254,176	216,330	170	170	29,647	17,587	377,707	
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	102,310	94,991	92,993	76,161	4,745	2,368	25,758	6,972	180,492	
7	Arsimi	AG109	610,820	488,144	151,471	95,836	3,750	2,792	271,959	198,948	785,720	
8	Mbrojtja Civile	AH109	162,740	145,101	46,887	32,603	23,157	19,208	84,464	38,303	235,215	
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109	-	-	-	-	17,000	-	-	17,000	-	
TOTALI			1,758,907	1,526,636	1,094,780	841,516	212,130	57,778	932,394	550,785	2,976,715	

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2025 (Transferite e Pakushtezuar + Te ardhura)												Në mijë lekë	
Programi	kod/Progr ami	Shpenzime Personeli		Shpenzime Operative		Transferita+ Subvencione		Shpenzime Kapitale		Total Buxheti			
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt		
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	419,720	400,820	130,904	100,884	37,455	12,137	32,715	26,393	620,794	540,234	
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	41,020	37,693	5,044	4,024	108,486	3,748	7,034	2,484	161,584	47,949	
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	144,201	110,707	75,914	44,275	9,654	9,654	418,734	227,551	648,503	392,187	
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	24,405	21,518	265,057	217,350	40	40	35,453	21,372	324,955	260,280	
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	163,020	143,620	254,176	216,330	170	170	29,647	17,587	447,013	37,707	
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	102,310	94,991	87,443	70,671	4,745	2,368	25,758	6,972	220,256	175,002	
7	Arsimi	AG109	63,152	51,743	137,782	88,356	2,980	2,034	220,705	156,364	424,619	298,497	
8	Mbrojtja Civile	AH109	145,429	127,790	40,887	26,603	23,157	19,208	81,273	35,190	290,746	208,791	
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	AI109	-	-	-	-	17,000	-	-	-	17,000	-	
TOTALI			1,103,257	988,882	997,207	768,493	203,687	49,359	851,319	493,913	315,5470	2,300,647	

Realizimi i shpenzimeve Nga Transferta Sektoriale për vitin 2025													në mijë lekë
Programi	kod/Programi	Shpenzime Personeli		Shpenzime Operative		Transferta+ Subvencione		Shpenzime Kapitale		Total Buxheti			
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt		
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
2	Rendi dhe Siguria Publike	49,610	47,902	7,507	6,327	4,987	4,974	11,656	132	73,760	59,335		
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	35,792	34,515	20,537	16,613	250	250	3,800	-	60,379	51,378		
4	Mbrojtja e Mjedisit	-	-	28,928	28,928	-	-	-	-	28,928	28,928		
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
7	Arsimi	547,668	436,401	13,689	7,480	770	758	47,225	42,584	609,352	487,223		
8	Mbrojtja Civile	17,311	17,311	6,000	6,000	-	-	-	-	23,311	23,311		
9	Fondi rezerve & Kontigjenca	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
TOTALI		650,381	536,129	76,661	65,348	6,007	5,982	62,681	42,716	795,730	650,175		

Realizimi i shpenzimeve Nga Transferta e Pakushtezuar për vitin 2025												
Programi	kod/Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ bvençione		Shpenzime Kapitale		Total Buxheti		Në mijë lekë
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	188,950	187,522	66,977	63,048	9,095	2,369	464	265,486	252,939	
2	Rendi dhe Siguria Publike	AB109	26,420	26,378	2,320	2,180	80	80		28,820	28,638	
3	Çështjet Ekonomike dhe Bujqësia	AC109	104,021	98,735	15,195	12,926	180	180	97,024	87,462	199,303	
4	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	16,160	16,038	33,380	33,269	40	40	78	49,638	49,347	
5	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	123,650	12,040	80,174	76,793	170	170	4,705	2111	199,114	
6	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	84,310	84,310	38,681	36,498	2,445	1,568	5,579	5,170	127,546	
7	Arsimi	AG109	52,792	51,743	43,683	40,507	2,940	2,000	50,989	42,814	137,064	
8	Mbrojtja Civile	AH109	117,799	116,907	13,891	12,311	20,117	18,997	11,810	11,311	159,526	
9	Fondi rezervë & Kontigjenca	AI109										
TOTALI			714,102	701,673	294,301	277,532	35,067	25,404	170,649	148,868	1,214,119	1,153,477

Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë Limiti për vitin 2025

në mijë lekë

N r	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ Subvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	AA109	-	-	426	64	2,436	2436	80	-	2,942	-
2	Mbrojtja e Mjedisit	AD109	-	-	-	-	-	-	11,049	11,043	11,049	-
3	Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike	AE109	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Argëtimi, Kultura, Sportet	AF109	-	-	5,550	5,490	-	-	-	-	5,550	-
5	Arsimi	AG109	-	-	-	-	-	-	4,029	-	4,029	-
6	Mbrojtja Civile	AH109	-	-	-	-	-	-	3,060	3,060	3,060	-
TOTALI			-	-	5,976	5,554	2,436	2,436	18,218	-	26,630	-

A) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore

Këto burime të ardhurash zënë një vënd kryesor në buxhetin e bashkisë pasi financojnë pothuajse të gjitha funksionet në administrim të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përbëjnë **79%** të totalit të buxhetit.

Gjatë vitit 2025, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi në mënyre racionale burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e funksioneve bazike dhe veçanërisht atyre sociale.


Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik:

Emertimi	PLANI 2025	FAKTI 2025	REALIZIMI %
Paga dhe Sigurime	1,103,257	988,882	90%
Shpenz. Operative	997,207	768,493	77%
Transferime	203,687	49,359	24%
Investime	851,319	493,913	58%
TOTALI	3,155,470	2,300,647	73%

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta, krahasuar me planin vjetor është **73%**, ose në vlerë **2,300,647** mijë lekë.

- Pagat janë realizuar në masën **90%**, ose në vlerë **988,882** mijë lekë;
- Shpenzimet operative janë realizuar në masën **77%**, ose në vlerë **768,493** mijë lekë;
- Transferimet janë realizuar në masën **24%** ose në vlerë **49,359** mijë lekë;
- Dhe investimet janë realizuar në masën **58%**, ose në vlerë **493,913** mijë lekë.

Paraqitja grafike:




Fondi rezerve në buxhetin e vitit **2025** është planifikuar në shumën **10,000 mijë lekë**, Gjatë vitit 2025 fondi rezervë është përdorur për shumën 3,000 mijë lekë me vendim të Këshillit Bashkiak nr.107, datë 03.09.2025, si ndihmë për Bashkinë Gramsh, për përballimin e pasojave të zjarreve të ndodhura në muajin gusht 2025.

Fondi i kontigjences në buxhetin e vitit **2025** është planifikuar në shumën **10,000 mijë lekë**, Gjatë vitit 2025 ky fond nuk është përdorur.

Investimet nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar:

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar **123,601 mijë lekë** nga transfertat e pakushtëzuar, **14,791 mijë lekë** nga transfertat sektoriale (specifike), **226,361 mijë lekë** nga fondet e trashëguara nga viti 2024, nga të ardhurat e vitit 2025 janë **465,524 mijë lekë** dhe të ardhura nga huaja **83,778 mijë lekë**, gjithsej **914,175 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:



Rreth **51%** e investimeve financohen nga të ardhurat e vitit, duke bërë që prokurimi dhe realizimi i tyre të varet shumë nga arkëtimi dhe realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Rreth **25%** të investimeve financohen nga fondet e trashëguara, **13%** të investimeve financohen me transfertën e pakushtëzuar, **9%** e investimeve financohen me të ardhura nga huaja dhe nga transfertat sektoriale financohen **2%** e investimeve.

Investimet (shpronësimet) nga huaja nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim dhe proceseve gjyqesore mes trashëgimtarëve.

B) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtezuar sektoriale

Në vitin 2025 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki janë:

i. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Për arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve), janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 252 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashkollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) dhe mesëm përgjithshëm janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 172 punonjës të transferuar.

i. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë alokuar fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Numri i punonjësve është 37.

ii. Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond përfshihen shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2025 numri i punonjësve është 10.

Bashkia Elbasan në strukturën organizative të saj, ka krijuar Agjensinë e Pyjeve, Bujqësisë, dhe Mjedisit, në të cilën bën pjesë Drejtoria e pyjeve, e cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Gjithashtu, meqënëse fondet nga transferata sektoriale janë të pamjaftueshme për këtë shërbim, Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

iii. Rrugët rurale

